

HAPJE DËGJESE

SUBJEKTI:

"PANTHER ALBANIA" sh.p.k

L97002201S

**VENDNDODHJA: Vlore, Qender Vlore, Babice, Babice
e Madhe, numer pasurie 343/2, indeks harte K34-
124-(129-D).**



Handwritten signature and circular blue stamp of SINAMATI Sh.p.k. The stamp contains the text: NUIS: M4131007S, SINAMATI Sh.p.k, Tirana - Albania.

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Qellimi i projektit:

Subjekti "PANTHER ALBANIA" sh.p.k eshte e regjistruar ne organet tatimore me nr identifikimi NIPT: L97002201S.

Vendodhja e ushtrimit te veprimtarise: Vlore, Qender Vlore, Babice, Babice e Madhe, numer pasurie 343/2, indeks harte K34-124-(129-D).

Subjekti "PANTHER ALBANIA" sh.p.k do te aplikojte per Leje Mjedisi tipi B.

Klasifikimi bazuar ne ligjin 10448:

ID 7.12 o.Prodhimi i këpucëve.

Objektivat e aktivitetit

1. Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore te ketij instalime te cilat jane:
 - Emetimet ne ajer dhe zhurmat
 - Ndikimi ne flore/faune
 - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve
 - Ndikime social-ekonomike
 - Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
 - Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
 - Ndikim ne peizazhin e zones
2. Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqësore me mjedisin.



Vendodhja dhe karakteristikat fizike te projektit

- Instalimi dhe aktivitetet e tij

Operatori "**PANTHER ALBANIA**" sh.p.k do te ushtroje aktivitetin:
ID 7.12 o.Prodhimi i këpucëve.

Vendi ku ushtrohet aktiviteti eshte: **Vlore, Qender Vlore, Babice, Babice e Madhe, numer pasurie 343/2, indeks harte K34-124-(129-D).**

Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

Subjekti do te aplikoj per leje mjedisi tipi B si me poshte:



Procesi teknologjik

Veprimtaria e subjekti "**PANTHER ALBANIA**" sh.p.k konsiston ne aktivitetin:
ID 7.12 o. Prodhimi i këpucëve.

Pershkrimi i veprimtarise se specifikuar:

Projekti parashikon prodhim, tregti me shumice dhe pakice, import-eksport i kepuceve ne pergjithesi dhe ne veçanti atyre te punes dhe te sigurise, sportive per kohen e lire, trekking, pushimi dhe veshje e aksesore te tjere per pune në Vlorë, Qendër Vlorë, Babicë, Babibë e Madhe. Porositës i projektit është subjekti "PANTHER ALBANIA" sh.p.k. Për hartimin e projektit teknologjik për këtë objekt, janë marre ne konsiderate:

- Detyra e projektimit e dhëne nga investitori
- Ligji 8450 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve te tyre
- Ligji 8766 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin"
- Ligji 8378 "Kodi rrugor i Republikës se Shqipërisë"
- VKM Nr. 1062 dt.23.12.2015, " Për pajisjet dhe bashkësitë nen presion"
- "Kushtet teknike dhe normat e projektimit për instalimet qe shërbejnë për depozitimin, transportin dhe tregtimin e naftës dhe nënprodukteve te saj."Nr.184,date 5.07.2005. - Standardet teknike për zgjedhjen e materialeve dhe aparaturave ne përputhje me cilësitë fiziko mekanike të lëndës qe do të tregtohet.

Magazina

Reparti i magazinës është pika e parë dhe themelore në një fabrikë suprinash. Këtu kryhet pranimi i materialeve të para si lëkura natyrale, lëkurat sintetike, tekstilet, materialet mikrofibër, si dhe të gjitha aksesorët ndihmës që përdoren në procesin e prodhimit të suprinave (zinxhirë, elastikë, astarë, përforcime, ngjitësa etj.). Pas pranimit, materialet kontrollohen me kujdes për të parë nëse përputhen me standardet e cilësisë të kërkuara nga porositësi apo kontrata e furnizimit. Ky kontroll përfshin inspektimin vizual për defekte sipërfaqësore, matjen e trashësisë së lëkurës apo tekstilit, krahasimin e ngjyrave dhe qëndrueshmërinë e materialit. Pasi kryhet kontrolli, materialet regjistrohen në sistem dhe vendosen në kushte të përshtatshme magazinimi. Për shembull, lëkurat natyrale duhet të ruhen në ambiente të ajrosura, me temperaturë dhe lagështi të kontrolluar, në mënyrë që të mos deformohen apo të humbasin elasticitetin. Nga ana tjetër, materialet sintetike dhe tekstilet zakonisht ruhen të rrotulluara ose të shtrira për të shmangur palosjet. Organizimi i mirë i magazinës siguron jo vetëm ruajtjen e cilësisë së materialeve, por edhe lehtëson furnizimin e shpejtë dhe të rregullt të repartëve të tjera sipas nevojave të prodhimit.

Prerja

Reparti i prerjes është një ndër pikat më të rëndësishme të procesit teknologjik. Në këtë fazë, materialet bazë si lëkura dhe tekstilet priten sipas shablloneve të modelit që do të prodhohet. Prerja mund të kryhet me disa metoda: prerja klasike me fustela metalike të vendosura në makina prese ose prerja manuale për seritë e vogla ose për materiale të veçanta. Gjatë prerjes, qëllimi kryesor është të përdoret materiali në mënyrë sa më ekonomike, duke minimizuar humbjet. Për këtë arsye, vendosja e shablloneve mbi material bëhet me kujdes, duke respektuar gjithmonë drejtimin e fibrave të lëkurës ose të tekstilit për të siguruar qëndrueshmëri dhe pamje të njëtrajtshme të produktit final. Pas prerjes, pjesët e marra kontrollohen në mënyrë individuale për defekte të mundshme dhe grupohen sipas modeleve dhe numrave të këpucëve që do të prodhohen. Ky repart kërkon operatorë të kualifikuar, pasi gabimet në prerje ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe koston e prodhimit.

Përgatitja

Pas prerjes, pjesët e suprinave kalojnë në repartin e përgatitjes, ku ato përpunohen dhe përgatiten për proceset e mëtejshme të qepjes dhe montimit. Ky repart përfshin disa operacione të rëndësishme:

- **Shkajimi:** hollimi i skajeve të lëkurës ose tekstilit, në mënyrë që bashkimi i pjesëve me qepje të mos rezultojë voluminoz dhe produkti final të ketë pamje estetike të rregullt.
- **Spaltimi:** ndarja e materialeve për të arritur trashësinë e kërkuar, duke u siguruar që të gjitha pjesët e një çifti të jenë uniforme.
- **Ngjitja e përforcimeve:** shtimi i materialeve të forta (puntalë, mbajtëse thembre, interfodera) në zonat ku nevojitet qëndrueshmëri më e madhe.
- **Bashkimi:** bashkimi i dy materialeve të ndryshëm (p.sh. lëkurë me astar) përmes ngjitjes, duke siguruar që pjesët e tomaes të kenë qëndrueshmëri dhe estetike. Në këtë repart punohet gjithashtu me ngjitësa dhe makina ngjitëse që përdorin temperatura të kontrolluara për të siguruar aderimin e duhur. Përgatitja është një hap themelor, pasi nga cilësia e këtyre operacioneve varet edhe cilësia e qepjeve dhe pamja e suprinës në fazat e mëvonshme.

Qepja në linjat e punës + Strobel

Qepja e pjesëve të suprinës është një proces i specializuar që kryhet në reparte me linja pune dhe makina qepëse industriale. Fillimisht bëhet qepja, që është palosja dhe përforcimi i skajeve të materialit, duke i qepur ose ngjitur ato për të pasur një pamje të rregullt dhe për të parandaluar grisjen. Pas kësaj, pjesët e ndryshme të suprinave (pjesa e përparme, anësoret, pjesa e pasme, gjuha, astari etj.) qepen së bashku. Makineritë që përdoren në këtë repart janë të ndryshme: qepëse klasike me 1 ose 2 gjilpëra (Pfaff, Durkopp Adler), makina Strobel për bashkimin e pjesës së sipërme me astarin, makina zig-zag për dekorime ose përforcime, si dhe makineri travettatrice për qepje të shkurtra dhe të forta në zona të caktuara. Ky repart është një nga më të rëndësishmit, pasi përcakton estetikën dhe forcën mekanike të suprinave. Operatorët duhet të jenë të specializuar dhe të kujdesshëm, sepse qepjet e shtrembra, tensioni i gabuar i fijeve ose materialet e vendosura keq ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e produktit final.

Montimi

Montimi i suprinave është faza ku pjesët e përgatitura dhe të qepura bashkohen për të formuar strukturën përfundimtare. Në këtë fazë bëhet aplikimi i përforcimeve në zonat kyçe si pjesa e përparme dhe thembra, si dhe vendosja e tomaes mbi kallëp (forma e këpucës) për të marrë formën e duhur. Montimi kërkon kujdes maksimal, pasi gjatë këtij procesi përcaktohet komforti dhe estetika e produktit final. Përdoren makina për ngrohje, për formësim dhe për ngjitje, të cilat e ndihmojnë materialin të përshtatet mirë me formën e kalipit. Në këtë fazë kontrollohet gjithashtu simetria e palëve (majtas-djathtas) dhe bëhen ndërhyrje korigjuese nëse është e nevojshme. Ky repart është ura lidhëse midis punimeve të suprinave dhe procesit të përfundimit të këpucës, ndaj cilësia e montimit është vendimtare për rezultatin përfundimtar.

Paketimi

Pas përfundimit të montimit dhe pastrimit të produktit nga mbetjet e ngjitësit ose fijet e tepërta, suprinat kalojnë në kontrollin final të cilësisë. Këtu verifikohet që qepjet të jenë të forta dhe të rregullta, materialet të mos kenë defekte dhe produkti të përputhet me mostrat e miratuara nga klienti. Pas kontrollit, produktet pastrohen dhe përgatiten për paketim. Çdo palë vendoset në paketimin përkatës (qese plastike ose kuti kartoni), etiketohen me kodin e artikullit, masën dhe informacionin e klientit. Për sasi të mëdha, paketimi bëhet në kuti transporti të mëdha, të përshtatura për ruajtjen e integritetit të produkteve gjatë transportit. Paketimi është procesi i fundit, i cili i jep produktit pamjen e organizuar dhe të sigurt për t'u transportuar. Në këtë mënyrë, suprinat janë gati për t'u dërguar tek klienti, ku do të vazhdojnë procesin e montimit të tabanit dhe përfundimit të këpucës.



— Burimet e shkarkimeve nga instalimi

Shkarkime ne ajer – Nga zhvillimi i aktivitetit te prodhimit te kepuceve nuk parashikohet shkarkime direkte ne ajer. Megjithate mund te kete shkarkime te mundshme nga mjetet e transportit qe hyjne dhe dalin per te sjell lenden e pare apo per te terhequr produktin final per eksport apo import. Keto shkarkime jane te ulta duke mos ndikuar ne cilesine e ajrit te zones.

Shkarkime ne ujra- Ujrat qe do te perdoren eshte per pordorim sanitar te punonjesve sepse nuk ka perdorim te ujit ne procesin e punes. Keto shkarkime do te shkarkohen ne rrjetin ekzistues te kanalizimeve te zones. Shkarkimet e ujit jane te kufizuara prandaj nuk do te perfshijne substanca te rrezikshme apo mbetje nga procesi i punes.

Shkarkime ne toke- Nga aktiviteti nuk do te kete shkarkime ne toke, pasi procesi zhvillohet ne te gjitha masat teknike per te shmangur cdo ndotje te mundshme ne toke.

Gjenerimi i zhurmave- Zhvilli i aktivitetit pritet te sjell nje rritje shume te lehte te nivelit te zhurmes por kjo rritje do te jete e monitoruar qe mos te kaloje kufirin ligjor per gjenerimin e zhurmave qe kryesisht vjen nga mjetet e transportit, dhe pajisjet teknologjike gjate prodhimit. Gjenerimi i zhurmave nga ky subjekt eshte minimale dhe nuk pritet te kete asnje ndikim negativ ne mjedisin perreth.



- Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes

Vendi i zhvillimit të aktivitetit disponon të gjithë kapacitetin dhe hapësirën për të operuar pa krijuar ndotje dhe shqetësime.

- Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis

Shkarkimet që vijnë si pasojë e zhvillimit të aktivitetit nuk mund të konsiderohen ndotese. Këto shkarkime do të jenë normale, brenda legjislacionit aktual në fuqi. Operatori do të marrë masa të vazhdueshme për minimizimin sa më të madh të tyre, duke bërë edhe monitorimet përkatëse për komponentet e cituar në Anekset e mesipërme.

NDIKIME NEGATIVE NE MJEDIS
Rrezatimi Jonizues
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese.
Vibracionet
Funksionimi i aktivitetit nuk gjeneron vibrime.
Ndikimet ne popullsi
Realizimi i projektit nuk do të ketë ndikime në lëvizjen apo zhvendosjen e popullsisë së rajonit ku zhvillohet aktiviteti. Gjate funksionimit të aktivitetit nuk ka emetime në ajër, tokë apo ujë të cilat ndotin ambientin dhe të rrezikojnë shëndetin e punonjësve apo të popullsisë së rajonit.
Ndikimet ne toke
Aktiviteti i transferimit të mbetjeve nuk gjeneron shkarkime në tokë.
Mbetjet e ngurta
Mbetjet që do të menaxhohen duke u grumbulluar, transportuar nga një subjekt i licensuar ku subjekti ka lidhur kontratë për menaxhimin e mbetjeve që dalin nga procesi i punës me "AME Ambient" Shpk.
Ndikimet ne ajer
Referuar natyrës së aktivitetit mund të kemi ndikime negative shumë minimale në ajër megjithatë ato do të monitorohen periodikisht nga laborator i akredituar duke respektuar kushtet e lejes mjedisore.
Ndikimet ne ujera
Funksionimi i aktivitetit nuk do të ketë ndikime në ujera. Në ujera do të kemi vetëm shkarkimin nga pastrimi i shesheve të punës, dhe përdorim sanitar të cilat do të shkarkohen në kanalizimet e zonës.
Ndikimet ne klime
Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të permiresimit ashtu edhe në atë të perkeqesimit të saj. Nuk do të ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Për kryerjen e këtij aktiviteti nuk ndikon fare në kushtet klimaterike të kësaj zone.
Ndikimet ne floren dhe faunen
Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë urbane dhe nuk mund të analizojmë ndikime në florë dhe faunë. Operatori do të shtojë sipërfaqet e gjelberta për një pamje vizuale më të kënaqshme për syrin dhe për të mirat në pikepamjen mjedisore.
Ndikimet nga zhurmat

Aktiviteti i parashikuar nuk pritet të sjellë ndryshime të ndjeshme në këtë drejtim. Rritja e mundshme e nivelit të zhurmës do të jetë shumë e lehtë dhe kryesisht e lidhur me lëvizjen e mjeteve të transportit dhe pajisjet teknologjike gjate prodhimit. Ky ndikim konsiderohet i papërfillshëm dhe nuk pritet të shkaktojë shqetësime për mjedisin apo zonën përreth.

Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin

Infrastruktura ne te gjithë perimetrin e aktivitetit eshte e shtruar me beton gjithashtu edhe rruga kryesore qe kalon prane aktivitetit. Nuk pritet qe te kete ndikime negative apo ndryshime te infrastruktures.

Ndikimet e aktivitetit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike historike dhe zonat e mbrojtura

Aktiviteti që ushtron shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së ciles dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashëgimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar kete aktivitet.

Ndikime ne rrjetin hidrografik

Natyra e aktivitetit nuk kerkon perdorim te ujit.

Ndikimi social-ekonomik

Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit, ne aspektin e punesimit.



Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme

1. Teknikat më të mira të disponueshme " (TMD) do të thotë faza më efektive dhe e avancuar në zhvillimin e aktiviteteve dhe metodat e tyre të veprimit të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për të siguruar në parim bazat për vlerat limite të emetimeve të percaktuara për të parandaluar dhe ku nuk është e praktikueshme, në përgjithësi për të reduktuar emetimet dhe ndikimin e tyre në mjedis në tërësi:
2. 'Teknika' përfshin të dyja si teknologjine e përdorur dhe mënyren në të cilën impianti është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, operuar dhe çmontuar.
3. Teknikat me të mira të disponueshme' do të thotë ato që janë të zhvilluara në një shkallë që lejon zbatimin në sektorin përkatës industrial, nën kushte ekonomike dhe teknike të zbatueshme, duke marrë parasysh kostot dhe përparësitë, nëse janë apo nuk janë përdorur ose prodhuar teknikat brenda territorit të Pales në fjalë, për aq kohë sa ato janë mjaft të lejueshme për operatorin;
4. Me të mirë ' do të thotë më efektiv në arritjen e një niveli të përgjithshëm të lartë të mbrojtjes së mjedisit në tërësi. Në përcaktimin e teknikave më të mira të disponueshme, konsideratë të veçantë duhet t'i jepet, në përgjithësi, ose në raste të veçanta faktorëve të mëposhtëm, duke pasur parasysh kostot me të mundshme dhe përfitimet nga një masë dhe parimet e masës paraprake dhe parandalimit:
5. Proceset e krahasueshme, pajisjet apo metodat e funksionimit të cilat kanë qenë provuar me sukses në një shkallë industriale;
6. Përparimet teknologjike dhe ndryshimet në njohuri shkencore dhe të të kuptuarit;
7. Natyra, efektet dhe vëllimi i emetimeve në fjalë;
8. Datat e montimeve për instalimet e reja apo ekzistuese;
9. Koha e nevojshme për të futur teknikën më të mirë të mundshme;
10. Konsumi dhe natyra e lëndëve (përfshirë ujin) të përdorura në proces dhe efikasitetin e saj të energjisë;
11. Nevoja për të parandaluar apo zvogëluar në minimum ndikimin e përgjithshëm të emetimeve në mjedis dhe rreziqet për të;
12. Nevoja për të parandaluar aksidentet dhe për të minimizuar pasojat e tyre për mjedisin. Koncepti i teknikave më të mira të disponueshme nuk i drejtohet këshillimit të ndonjë teknike ose teknologjie të veçantë, por marrjes parasysh të karakteristikave teknike të impianteve në fjalë, pozitën e saj gjeografike dhe kushtet lokale mjedisore

Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme)

1. Mbajtja e regjistrave për sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe depozitimi i tyre në harqe kohore 6-mujore në instancat shtetërore përkatëse.
2. Menaxhimi i mbetjeve që dalin nëpërmjet subjektit menaxhohen nga një subjekt i licensuar "AME Ambient" Sh.p.k.

Masat për përdorimin eficient të energjisë

1. Auditimi vjetor, nga auditues në procese për evidentimin e përdorimit eficient të energjisë.
2. Kualidimi i vazhduar i impianteve.
3. Vlerësimi nga menaxheri i energjisë për gjendjen e impiantit dhe vlerësimin e pjesëve me të reja.
4. Vendosja apo zëvendësimi i pajisjeve jo më vonë se 2 vjet pas përfundimeve të dalta nga Audituesi i Energjisë.

Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:

Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme

Natyra e një aktiviteti të tillë nuk preket nga ndërprerje sezonale. Për këtë arsye ndërprerjet definitive do të shoqërohen me zbatimin e planit të cmontimit të instalimit dhe zbatimin e plote të planit të rehabilitimit të mjedisit postfungsionim. Gjithashtu për ndërprerje të tilla si pasoje e avarive që shoqërohen me ndotje të tipeve të ndryshme duhet të njoftohen instancat shtetërore. Megjithatë aktivitetit nuk parashikon ndërpreje apo mbyllje të aktivitetit.

Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Qëllimet e monitorimit mjedisor: Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë. Është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga faktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar

Monitorimi i Planifikuar	
Monitorimi i parametrave mjedisore (ajer dhe zhurme)	Cdo 6 muaj
Monitorimi i trajnimeve te stafit ne raste emergjente	Cdo 6 muaj-1 vit
Monitorimi i gjendjes mekanike te pajisjeve operuese	Cdo 1 muaj nga mekanike te posacem
Monitorimi i perdorimit eficient te energjise	Cdo 1 vit nga kompania dhe cdo 2 vjet nga Audituesi i Energjise



Relacion joteknik

Planvendosja e subjektit:



Vendndodhja e subjektit "PANTHER ALBANIA" sh.p.k

Koordinatat e veprimtarisë sipas sistemit GAUSS KRUGË ZONE 4		
Sipërfaqja e ushtrimit të aktivitetit Kapanoni		
Nr	X	Y
1	4374291.32	4484318.67
2	4374346.41	4484341.84
3	4374313.44	4484268.84
4	4374369.72	4484292.29

Koordinatat ne Gauss- Kruger te vendndodhjes